



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:116005

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05525313

C.nr.1799/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Njomëza Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.K.P. nga Prizreni, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokat N.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, me objekt kontesti padi për kompensimin e pagave jubilarë, vlera e kontestit 880.26 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 29.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadija e paditëses E.K. - Pepnik nga Prizreni me të cilin ka kërkuar që të *“Detyrohet e paditura Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, që paditëses, në emër të shpërblimit jubilar, t`ia paguaj dy paga në shumën prej 880.26 euro, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm” e pabazuar.*

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja E.K.P. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj, në këtë Gjykatë me datën 07.06.2022, ka parashtruar padi për kompensimin e pagave jubilarë, kundër të paditurës Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, me vlerë të kontestit 880.26 euro.

Në padi, i autorizuari i paditëses ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, e sistemuar në vendin e punës si Teknike e Transfuzionit të Gjakut në Spitalin Rajonal në Prizren dhe ka mbi 14 vite përvojë pune. Fillimisht e njëjta ka qenë në marrëdhënie pune pranë të paditurës nga data 01.08.2007 deri me 31.12.2014 tutje nga data 01.01.2015 e deri me sot është e sistemuar si teknike e transfuzionit në Qendrën Kombëtare të Kosovës për

Transfuzion. Andaj për përvojën e punës pranë të paditurës ka kërkuar dy paga mujore në emër të shpërblimit jubilar në lartësi prej 880.26 euro.

E paditura Spitali i Përgjithshëm në Prizren, me datë 21.11.2023, në përgjigje në padi ka theksuar paditësja punon në Qendrën e Transfuzionit të Gjakut në Prizren, e cila është në kompetencën e SHSKUK-ës, dhe jo të Spitalit të Përgjithshëm të Prizrenit. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, kjo sepse nga faktet e treguara në padi, dhe prapësimet e ngritura nga e të paditurës rezulton qartazi se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar

Për gjykatën nuk ishte kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune, e caktuar në vendin e punës Teknike e Transfuzionit në Institucionin Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut (QKKTGJ) dhe e njëjta deri me datën 19.11.2021, i ka arritur gjithsej 14 vite, 3 muaj e 18 ditë përvojë pune, fakt ky i vërtetuar nga provat (vërtetimi, kontrata e punës dhe lista e pagave) të cilat gjinden në shkresat e lëndës, e të dorëzuara nga pala paditëse. Ndërsa, paraprakisht ka qenë e punësuar pranë të paditurës ku ka punuar 7 vite, 5 muaj e 0 ditë.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar nenit 399 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*, pasi nga kontrata e punës nr.119 e datës 09.01.2015, të cilën paditësja ja ka bashkangjitur shkresave të lëndës vërtetoi faktin se këtu paditësja E.K. ka lidhur kontratë pune për kohë të pacaktuar me Ministrin e Shëndetësisë përkatësisht me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut (QKKTGJ), i cili është institucioni me i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor nga fusha e veprimtarisë transfuzive, në pozitën Teknike e Transfuzionit në këtë Institucion, me vend të punës në Qendrën e Transfuzionit të Gjakut në Prizren. Andaj në bazë të lartcekurave punëdhënës i paditëses nuk është Spitali i Përgjithshëm në Prizren por Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut.

Në nenin 76 të LPK-ës parashihet se *“Gjatë tërë procedurës gjykata duhet të kujdeset, sipas detyrës zyrtare, nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedurale, nëse palën me pazotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor, dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizimin e veçantë, kur ai është i nevojshëm”*, meqë mungesa e legjitimitetit real pasiv është prezumim i natyrës materialo juridike, për të cilën gjykata duhet të kujdeset ex-officio gjatë gjitha fazave të procedurës dhe

meqë legjitimtetit real nënkupton detyrimisht një raport juridiko civil të palëve ndërgjyqëse për të drejtën e tyre subjektive për të cilën është filluar kontesti, gjykata është e detyruar që të refuzoj kërkesëpadinë e paditëses si të pathemeltë në mungesë të raportit juridiko civil, respektivisht të mungesës së legjitimitetit real pasiv andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, pasi që e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Nga arsyet e cekura me lart dhe bazuar në dispozitat e nenit 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.1799/22, datë 29.03.2024

Gj y q t a r j a

Njomëza Berisha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.